



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHERBIMEVE ARSIMORE

Nr. Prot.

Tiranë, më, 2023

NJOFTIM

Në zbatim të Rregullores së Maturës Shtetërore, maurantët/kandidatët që kanë dhënë provimet e MSH 2023, sesioni i parë, kanë të drejtë të kërkojnë kopjen e testit, pas përfundimit të të 4 (katër) provimeve të MSH.

Mauranti/kandidati që kërkon kopjen e testit, duhet të kryejë aplikimin online në portalin e-albania, duke përdorur shërbimin “**Kërkesë për kopje testi të Maturës**”, për të 4 (katër) provimet, **në datën 28 qershor 2023, ora 08.00 – 16.00.**

Pas trajtimit të kërkesës, QSHA do të nisë kopjen e testit për secilin maurant/kandidat që e ka kërkuar atë, në “Hapësira ime”, seksioni “Dokumentet e mia”, në llogarinë përkatëse të çdo mauranti/kandidati, në e-albania.